



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 630 Akti

Nr. 643 Vendimi
Tiranë, më 11.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brower, në datën 7.4.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Esmerilda Habili**, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Esmerilda Habili, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.12.2020 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjyqësore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor nr. 4, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e parë të trupit gjyqësor të datës 22.12.2022, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionere Alma Faskaj (Vokopola), si dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Esmerilda Habili nisi procesin e rivlerësimit dhe hetimin e thelluar administrativ.

6. Procesin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesin e vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesin e vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Esmerilda Habili. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 23.3.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit Esmerilda Habili; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës së subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 23.3.2023 u njoftua² mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit e ushtroi të drejtën për t'u njohur me aktet e dosjes në datën 27.3.2023, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave pranë Komisionit³ në datën 3.4.2023.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vendosi të ftojë⁴ subjektin në seancë dëgjimore me njoftimin nëpërmjet postës elektronike, në datën 5.4.2023.

¹ Akti kontrolli nr. *** prot., datë 12.12.2019.

² Nëpërmjet adresës elektronike me anë të së cilës është kryer komunikimi gjatë procesit të rivlerësimit.

³ Protokolluar me nr. *** prot.

⁴ Me vendimin nr. *** të trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë nëpërmjet postës elektronike me *email*, në datën 5.4.2023.

18. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Esmerilda Habili u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 7.4.2023, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brower.

19. Subjekti i rivlerësimit Esmerilda Habili u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit Esmerilda Habili kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Esmerilda Habili ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, për të sjellë prova dhe shpjegime gjatë të gjitha fazave të hetimit administrativ.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4 Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësisë profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5 Por, referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21.6 Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti pranë ILDKPKI-së me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite nga e subjektit pranë ILDKPKI-së; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (e) denoncimet e publikut; si dhe (ë) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijuarit të këtyre pasurive.

22.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Esmerilda Habili.

22.2 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë, si vijon:

23. Pasuri e llojit “likuiditet bankar” në llogarinë me nr. ***, pranë “Tirana Bank”. Gjendja në datën 26.1.2017 në shumën 69 lekë. Pjesa takuese: 100%.

23.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar pagë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Deklarimi i pasurisë ndër vite

23.2 Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim DIPP) të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer të njëjtin deklaram si në deklaratën *Vetting*, por me gjendje llogarie në këtë vit në shumën 215 lekë.

23.3 Konkluzion i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

➤ *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.*

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

23.4 Nga hetimi i Komisionit⁶ konfirmohet gjendja e kësaj llogarie, me burim nga paga e subjektit, duke e bërë deklaramin e subjektit në përputhje me dokumentacionin e administruar

më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 8.2.2021, e “Tirana Bank”.

në kuadër të hetimit dhe, për rrjedhojë, të mjaftueshëm në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

24. Pasuri e llojit “likuiditete bankare” në llogarinë me nr. ***, pranë “Raiffeisen Bank”. Mbyllur në datën 21.10.2016.

24.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Deklarimi i pasurisë ndër vite

24.2 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer të njëjtin deklaram, me burim të njëjtë krijimi, nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

24.3 Gjithashtu, në seksionin e të ardhurave të deklaratës, subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga për periudhën janar - qershor 2016 si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

24.4 Konkluzion i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

➤ *Përputhet deklarami i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.*

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

24.5 Nga hetimi i Komisionit⁷ konfirmohet gjendja e kësaj llogarie me burim nga paga, sikurse deklaruar nga subjekti, duke e bërë deklarimin e subjektit në përputhje me dokumentacionin e administruar në kuadër të hetimit dhe, për rrjedhojë, të mjaftueshëm në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Çështje të tjera

25. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka hetuar më tej, përtej deklarimeve të subjektit në deklaratat e pasurive, në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuadër, gjatë administrimit të pyetësorëve⁸ të dërguar nga Komisioni janë evidentuar disa adresa banimi ku ka jetuar subjekti gjatë viteve të ushtrimit të detyrës.

25.1 Pasi i janë kërkuar shpjegime për secilën adresë banimi, subjekti ka sqaruar⁹ se adresat i përkasin banesave që ka marrë me qira, me qëllim banimin në to gjatë kohëzgjatjes së ushtrimit të detyrës në gjykatat e Tiranës dhe Vlorës. Përkatësisht, për periudhën tetor 2014 – qershor 2016 subjekti ka sqaruar se ka banuar në rrugën “****”, Tiranë, në pasurinë nr. ***, në pronësi të shtetasit H.A, për të cilën ka deklaruar se ka pasur një kontratë verbale me të birin e pronarit, shtetasin F.A, për provueshmërinë e së cilës ka paraqitur një deklaratë noteriale¹⁰ të datës 2.2.2021, të lëshuar nga shtetasi F.A, si dhe certifikatë pronësie për pasurinë truall me sip. 344,5 m² dhe ndërtesë me sip. 160,5 m², në emër të shtetasit H.A. Sipas kësaj deklarate konfirmohet fakti se subjekti i rivlerësimit ka banuar me qira në banesën në pronësi të shtetasit H.A, për periudhën tetor 2014 – qershor 2016, ku ka paguar qiranë dorazi, në shumën 20,000 lekë/muaj.

25.2 Ndërsa për periudhën korrik 2016 – shkurt 2020, subjekti ka sqaruar¹¹ se ka banuar me qira në adresën lagjja “****”, rruga “****”, pallati pas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, kati ***, Vlorë dhe se për këtë marrëdhënie ka pasur kontratë verbale me pronaren e banesës, shtetasen Sh. O, së cilës i ka paguar vlerën 10,000 lekë/muaj. Subjekti ka paraqitur para Komisionit: kopje të njësuar të deklaratës noteriale¹², datë 26.1.2021, të lëshuar nga shtetasja Sh.O, sipas së

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021, e “Raiffeisen Bank”.

⁸ Shihni pyetjen nr. *** të pyetësorit nr. ***.

⁹ Shihni pyetësorin nr. ***.

¹⁰ Me nr. *** rep., nr. *** kol.

¹¹ Shihni përgjigjen e pyetjes nr. *** të pyetësorit nr.***.

¹² Nr. *** rep., nr. *** kol.

cilës provohet marrëdhënia e qirasë për një apartament me sip. 69 m², kati 9 i një godine shërbimi 2-9 kate, të ndodhur në adresën e sipërcituar, kundrejt shumës së qirasë 10,000 lekë/muaj; kontratë shitblerjeje¹³ të sendit të ardhshëm, datë 19.9.2016, të lidhur midis pronarëve¹⁴ të truallit dhe shtetas Sh.O, për blerjen e apartamentit nr. ***, me sip. 69 m²; kontratë investimi¹⁵, datë 27.9.2014, e lidhur midis pronarëve të truallit dhe shoqërisë investitore “****” sh.a., për ndërtimin e një godine banimi-shërbimi 2-9 kate në lagjen “****”, Vlorë; si dhe planimetrinë e godinës.

25.3 Komisioni, përveçse analizoi aktet provuese të paraqitura nga subjekti, hetoi në mënyrë të pavarur në lidhje me pasuritë e marra me qira nga subjekti, si dhe në kuadër të konfliktit të mundshëm të interesit të subjektit me qiradhënësit, gjatë kohëzgjatjes së ushtrimit të funksionit si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁶ dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë¹⁷. Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan *indicie* në lidhje me të drejta të tjera reale të subjektit mbi pasuritë e marra me qira, si dhe mbi ndonjë konflikt të mundshëm interesi të qiradhënëseve me subjektin e rivlerësimit, për shkak të ushtrimit të funksionit si magjistrate. Për rrjedhojë, Komisioni nuk ngriti dyshime të tjera në kuptim të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

25.4 Në kuadër të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni e ka shtrirë hetimin administrativ gjithashtu përtej deklarimeve të subjektit, me qëllim identifikimin e ndonjë pasurie/të drejta reale të padeklaruar nga subjekti. Nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan pasuri/të drejta reale të tjera, përveç atyre të deklaruara nga subjekti apo *indicie* të cilat mund të përbënin prova për kryerjen e hetimeve të tjera, në kuptim të kriterit pasuror.

Hetimi i kryer për prindërit e subjektit të rivlerësimit

26. Me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë dhe shterues, Komisioni kreu verifikime mbi pasuritë e prindërve të subjektit të rivlerësimit. Nga hetimi i kryer nuk rezultuan dyshime mbi krijimin apo shtimin e pasurive të paluajtshme dhe/apo pasurive të luajtshme gjatë periudhës në të cilën subjekti ka ushtruar funksionin e gjyqtarës, si dhe nuk u evidentuan transaksione të dyshimta të kryera prej tyre.

Analiza financiare për vitet 2014 – 2016

27. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën nëntor 2014 – 2016, sipas së cilës rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e qirasë, shpenzimet e udhëtimit, si dhe ato jetike, të evidentuara përgjatë periudhës së rivlerësimit.

Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

28. Në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë *Vetting*, si dhe nga verifikimi i saj dhe hetimi i kryer konstatohet se subjekti i rivlerësimit Esmerilda Habili ka kryer deklaram të saktë dhe të plotë, sikurse parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

28.1 Nga hetimi i Komisionit, si dhe bazuar në deklaratimet e subjektit, nuk u evidentua krijimi i ndonjë pasurie nga subjekti gjatë periudhës së rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka pasur

¹³ Me nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁴ Shtetasit M dhe Z. B.

¹⁵ Nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2023, dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.3.2023, si dhe shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2023.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2023, dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.2.2023.

mundësi të përballojë me burime të ligjshme të ardhurash shpenzimet e evidentuara gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

28.2 Trupi gjykues çmon gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer fshehje të pasurive apo deklarim të rremë, si dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

28.3 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

29. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Esmerilda Habili, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ajo ka apo ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

29.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 27.10.2017.

29.2 Në vijim, në kuadër të hetimit, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së¹⁸ përditësimin dhe deklasifikimin e raportit të kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit Esmerilda Habili.

29.3 DSIK-ja ka dërguar¹⁹ raportin për kontrollin e figurës, të përditësuar dhe deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 16.3.2023, të KDZH-së, sipas të cilit, konstatohet se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit Esmerilda Habili ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës; (ii) për subjektin e rivlerësimit Esmerilda Habili nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

29.4 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka konstatuar:

➤ *Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Esmerilda Habili.*

Hetimi i Komisionit

30. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

30.1 Nga hetimi i Komisionit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2023.

¹⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2023.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

31. Në përfundim, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të dhënat e kërkuara në deklaratën e kontrollit të figurës.

31.1 Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

31.2 Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Esmerilda Habili ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

32. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale²⁰, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri²¹ dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë²² dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

32.1 Referuar raportit të hartuar mbi bazën e kriterëve të vlerësimit sipas pikës 1 të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016²³, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Subjekti kualifikon drejt marrëdhënien juridike, objekt konflikti gjyqësor, si dhe përdor si referenca në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, kryesisht praktikën unifikuese të saj, si

²⁰ Me nr. *** prot., datë 9.3.202.

²¹ Dokumenti 1 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 21.4.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja civile me nr. regj. them. ***, datë 18.2.2015, që i përket paditësit F.Gj kundër të paditurve: (1) shoqëria “****” sh.a.; (2) shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”. Dokumenti 2 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 20.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështja civile me nr. regj. them. ***, datë 2.2.2015, që i përket paditësit V.A kundër të paditurit A. M, me objekt “Detyrimin e të paditurit të më kthejë shumën e marrë dhe të dëmshpërblejë për dëmin e shkaktuar. Pagimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore”. Dokumenti 3 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 23.1.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, çështja civile me nr. regj. them. ***, datë 14.11.2016, që i përket paditësit T.N kundër të paditurit *** Vlorë, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit nr. ***, datë 31.10.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të “****” sh.a., për lirimin nga detyra të paditësit T.N dhe zgjidhjes së kontratës nr. *** prot., datë 27.7.2016, të lidhur midis Këshillit Mbikëqyrës të “****” sh.a. dhe paditësit T.N, të bërë në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara etj.”.

²² Dosja nr. 1 – çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 23.2.2015 regjistrimi, në ngarkim të së pandehurës Xh.S, e akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike ose e impulseve telefonike”, e parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 20.3.2015. Dosja nr. 2 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 18.12.2014 regjistrimi, që i përket palëve: paditësit H. Gj kundër të paditurit O.S.T.Nj.O Tiranë, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të më shpërblejë në masën e 3 pagave mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit të Punës etj., e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 23.2.2015”. Dosja nr. 3 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 29.1.2015 regjistrimi, që i përket palëve: paditësit A.Z kundër të paditurit A. M, me objekt “pushim cenimi dhe shpërbllim dëmi”. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 3.7.2015. Dosja nr. 4 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 18.2.2015 regjistrimi, që i përket palëve: paditësit G.S, kundër të paditurit S.S, me objekt “zgjidhje martese me kërkesën e njërit bashkëshort”. Kjo çështje është e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.3.2015. Dosja nr. 5 – kërkesa penale nr. *** regjistri themeltar, datë 23.1.2015 regjistrimi, që i përket kërkuarit: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër shtetasit A.Gj, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike”, e parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, me objekt “Vleftësim i ligjshëm i arrestit në flagrancë të kryer ndaj shtetasit A.Gj dhe caktimi i masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj tij, e përfunduar me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 25.1.2015”.

²³ 1) Aftësitë profesionale; 2) aftësitë organizative; 3) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe 4) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

dhe atë të GJEDNJ-së. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vërehet se në procesin e analizimit të vendimeve subjekti i kushton rëndësi analizës së normës ligjore në nxjerrjen e konkluzioneve. Subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektive në çështjet që ka shqyrtuar, duke shfaqur aftësi shumë të mira gjatë kryerjes së procedurave gjyqësore, si dhe në administrimin e dosjeve gjyqësore. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarëve, si dhe nuk rezultoi të ishte regjistruar ndonjë ankesë për shkelje etike ndaj saj. Nga administrimi i burimeve për kryerjen e rivlerësimit konstatohet se subjekti i rivlerësimit është i paanshëm. Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi për të bashkëpunuar me administratën gjyqësore dhe kolegët, si dhe është e gatshme për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, të cilat i kanë shërbyer për të plotësuar më së miri formimin profesional dhe etik.

32.2 Bazuar në të dhënat e regjistrimit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë për subjektin e rivlerësimit.

Rivlerësimi i kryer nga Komisioni

33. Komisioni, përtej raportit të dërguar nga KLGJ-ja, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe dosjet e shortuara, që kanë shërbyer për kryerjen e vlerësimit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit, nga analizimi i të cilave nuk u evidentuan gjetje në kuptim të kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

DENONCIME

34. Në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 3 denoncime të ardhura pranë Komisionit. Nga administrimi dhe vlerësimi i tyre, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, u gjetën disa *indicie* në kuadër të kriterit profesional, për të cilat Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

34.1 Dy denoncime të përsëritura të shtetasit M.M²⁴, sipas të cilave janë denoncuar disa gjyqtarë dhe prokurorë, përfshirë këtu edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 15.1.2018, për caktimin e masës së sigurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 50, gjerat “c” dhe “ç” të Kodit Penal, ku rregullohen rastet e rrethanave rënduese në caktimin e masave, pasi ka vendosur ndaj shtetasit E.Z masën “arrest në shtëpi”, në rrethanat kur nuk duhej ta vendoste, pasi subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të rrezikshmërisë së tij, për shkak të vendimit nr. ***, datë 15.11.2016, dhënë ndaj këtij shtetasi për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar në nenin 278/2 të Kodit Penal. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se vendimi i dhënë nga subjekti për vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit Z është marrë në kundërshtim me nenin 252 të Kodit të Procedurave Penale. Denoncuesi ka kërkuar të verifikohet vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të kryhet vlerësim ndaj saj, duke i bashkëlidhur denoncimit disa akte provuese²⁵.

34.2 Duke vlerësuar faktet e paraqitura në denoncim, Komisioni kërkoi dhe administroi dosjen e plotë gjyqësore²⁶, nga ku vërehen këto fakte: (i) në datën 15.1.2018, subjekti i rivlerësimit ka

²⁴ Përkatësisht denoncimet nr. *** prot., datë 26.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 29.1.2019.

²⁵ Kopje të vendimit nr. ***, datë 15.1.2018 (gjeneruar nga *web-i* i gjykatës), të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, dokumentacion ankimor të paraqitur në institucionet e drejtësisë, disa foto që duket se tregojnë dëmtime trupore të pësuar, si dhe një dokument në gjuhën italiane (gjithsej 3 fletë), nëpërmjet të cilit ka denoncuar se i dyshuari është i kërkuar ndërkombëtarisht për lëndë narkotike.

²⁶ Shkresë nr. **** prot., datë 28.2.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

vendosur me vendimin nr. *** vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit Z, të dyshuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal; (ii) caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” ndaj shtetasit E.Z; (iii) urdhërohet lirimi i menjëhershëm i shtetasit E. Z nga dhomat e paraburgimit; (iv) urdhërohet shtetasi E. Z të mos largohet nga banesa e tij apartament, ndodhur në lagjen “***”, pallati i ri, Vlorë; (v) urdhërohet policia gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.

34.3 Nga analizimi i fakteve të përmbajtura në vendim ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 13.1.2018, ka paraqitur pranë gjykatës kërkesën penale me objekt “vleftësim i ligjshëm i arrestit në flagrancë” dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj shtetasit E.Z, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, për shkak se në datën 11.1.2018 dyshohet të ketë goditur me levë hekuri shtetasin M.M (denoncuesi), i cili është dërguar në spital.

34.4 Nga aktet e dosjes penale dhe, konkretisht, bazuar në procesverbalin për kallëzimin e veprës penale, shtetasi M.M ka kallëzuar se ka pasur disa konflikte pronësie me shtetasin A.M dhe vëllain e tij, për të cilin është kanosur disa herë nga ata, si dhe nga shtetasi E.Z (i dyshuari). Lidhur me ngjarjen ai ka shpjeguar se ka qenë duke ecur për te parkingu, ku kishte lënë automjetin e tij dhe nga mbrapa ka ndier një goditje pas koke, ku një djalë i maskuar e ka qëlluar me levë disa herë mbi kokë dhe nga shmangia është qëlluar në këmbën e majtë duke rënë në tokë. Ai ka sqaruar se autori është larguar. Nga kryerja e veprimeve të para hetimore është arritur të identifikohet me foto shtetasi Z, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale. Nga kryerja e aktekspertimit mjekoligjor është konkluduar, ndër të tjera, se tek i dëmtuari konstatohen plagë në kokë, dëmtime të cilat sjellin paaftësi të përkohshme mbi 9 ditë.

34.5 Referuar këtyre fakteve hetimore, është arrestuar shtetasi E.Z si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, duke proceduar në vijim, në datën 13.1.2018, me kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj shtetasit E.Z, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”.

34.6 Subjekti i rivlerësimit, si fillim, ka vlerësuar rrethanat e mundshme dhe kushtet e flagrancës së të dyshuarit, ku pasi ka analizuar raportin e shërbimit të datës 11.1.2018 në lidhje me gjetjen dhe shoqërimin e shtetasit Z, ka vlerësuar se nuk ekziston asnjë rrethanë flagrante, pasi i dyshuari nuk rezulton të jetë kapur në kryerje e sipër të veprës penale, të jetë ndjekur nga policia gjyqësore menjëherë pas kryerjes apo të jetë kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se e ka kryer veprën penale, bazuar në nenin 251 të Kodit të Procedurave Penale. Për rrjedhojë, ka vendosur vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit Z, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”.

34.7 Në lidhje me caktimin e masës së sigurimit personal, subjekti i rivlerësimit, pasi ka arsyetuar kriteret sipas nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar se masa e përshtatshme për të dyshuarin është “arrest në shtëpi”, duke konsideruar mekanizmin e ngjarjes, rrezikshmërinë e veprës, pasojat e ardhura, personalitetin e të dyshuarit, si dhe faktin se vepra penale për të cilën dyshohet autori është kundërvajtje penale.

34.8 Vërehet më tej se vendimi është ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë pranë Gjykatës së Apelit, e cila, me vendimin nr. ***, datë 31.1.2018, ka vendosur: (i) lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë lidhur me vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë; (ii) ndryshimin e vendimit të mësipërm lidhur me masën e sigurimit duke u ndryshuar nga “arrest në shtëpi” në “detyrim paraqitjeje pranë organeve të policisë gjyqësore”; (iii) urdhërohet personi nën hetim E.Z të paraqitet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 12:00.

34.9 Në analizimin e vendimmarrjes së subjektit, Komisioni ndaloi në pretendimin e denoncuesit se subjekti ka qenë në dijeni të rrezikshmërisë së shtetasit Z, duke mos e konsideruar si rrethanë rënduese dënimin e tij me vendimin nr. ***, datë 15.11.2016, për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar në nenin 278/2 të Kodit Penal. Lidhur me këtë vendim penal konstatohet se ky vendim është bërë pjesë e fashikullit gjyqësor, kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë për të vlerësuar në lidhje me rrethanat rënduese, ku vihet re se subjekti nuk e ka injoruar këtë vendim, por e ka referuar atë në arsyetimin e saj për të analizuar personalitetin e personit nën hetim, shtetasin Z, edhe pse vendimi nuk kishte marrë formë të prerë. Sipas këtij vendimi (nr. *** datë 15.11.2016) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, referohet se shtetasi E.Z është deklaruar fajtor për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar në nenin 278/2 të Kodit Penal, sipas të cilit i është dhënë një vendim përfundimtar me 2 vite burgim, si dhe ndaj tij është aplikuar neni 59 i Kodit Penal, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim dhe urdhërimin e tij që të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

34.10 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka analizuar këtë fakt në drejtim të vlerësimit të personalitetit të tij, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për të cilën është akuzuar personi nën hetim, e cila është kundërvajtje penale, rrethanat familjare, si baba i dy fëmijëve të mitur ndaj të cilëve duhet kushtuar kujdes, ka vendosur si masë të përshtatshme “arrest në shtëpi”, duke pasur parasysh nevojën e sigurimit në rastin konkret, si kriter përcaktues në caktimin e masës së sigurimit personal, sipas nenit 229²⁷ të Kodit të Procedurës Penale.

34.11 Nga analizimi i dispozitivit të vendimit, Komisioni ndaloi te mekanizmi i caktuar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të vendimit të masës “arrest në shtëpi”, nëpërmjet policisë gjyqësore dhe jo me mjetet e mbikëqyrjes elektronike, sikurse kërkohet në germën “a” të nenit 4, si dhe në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nr. 10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

35. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka vlerësuar si masë të përshtatshme mbikëqyrjen prej policisë gjyqësore sesa atë elektronike, nisur nga efikasiteti i kësaj të fundit në aplikimin e rasteve të ngjashme. Në këtë kuadër, subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit edhe një raport të lëshuar nga Ministria e Financave²⁸ gjatë inspektimit të kryer në Ministrinë e Drejtësisë me temë “Mbi inspektimin financiar publik të kryer në Ministrinë e Drejtësisë”, për periudhën 2016 - 2017, sipas të cilit është konkluduar në lidhje me inefficiencën e sistemit të mbikëqyrjes elektronike, duke shkaktuar për rrjedhojë edhe dëm ekonomik në vlerë të konsiderueshme. Në përfundim, subjekti ka konkluduar se mbikëqyrja nga policia gjyqësore, në vlerësimin e saj, ka qenë më e përshtatshme, me qëllim zbatimin e masës së sigurimit, garantimin e efektivitetit dhe realizimin e funksionit të saj.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

36. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe e dëgjoji atë në seancën dëgjimore, çmon se subjekti ka shpjeguar bindshëm se në lidhje me caktimin e mekanizmit të mbikëqyrjes ka vlerësuar përshtatshmërinë për zbatimin në praktikë të masës së sigurimit, me

²⁷ Neni 229 “Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal”: “1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

²⁸ Paraqitur në cilësinë e provës.

qëllim garantimin sa më efektiv të tij e në këtë kuptim ka disponuar që masa “arrest në shtëpi” të mbikëqyret nga policia gjyqësore.

36.1 Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion bazuar në dispozitat e ligjit nr. 10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, dispozita²⁹ këto, të cilat nuk janë urdhëruese, por e lënë në vlerësim të gjyqtarit të çështjes vendimmarrjen për përcaktimin e mbikëqyrjes elektronike në rastet e masave të sigurimit.

37. Denoncim i shtetasit J.D³⁰, i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe një subjekt tjetër si anëtarë të trupit gjykues për dhënie vendimi të padrejtë. Nga administrimi i dokumentacionit mbështetës të paraqitur nga denoncuesi evidentohet një konflikt civil pronësie i denoncuesit, si dhe familjarëve të tjerë të familjes D me Këshillin e Ministrave, për një pasuri të paluajtshme të kthyer me vendim të KKKP-së Vlorë shtetasve D, për të cilën subjekti i rivlerësimit bashkë me anëtarët e tjerë të trupit gjykues kanë disponuar me vendim gjyqësor.

37.1 Komisioni, duke vlerësuar faktet e trajtuara në denoncim, kërkoi³¹ dhe administroi dokumentacionin në lidhje me këtë çështje³². Me vendimin nr. *** datë 3.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur: (i) pranimi pjesërisht i padisë; (ii) anulimi i vendimit nr. ***, datë 14.6.2006, të KVKKP-së Vlorë; (iii) njohja e të drejtës së pronësisë së shtetit shqiptar mbi pasurinë tokë kullotë; (iv) rrëzimi i pjesës tjetër të padisë; dhe (v) ligjërimi i sigurimit të padisë. Vërehet se në këtë vendim subjekti i rivlerësimit ka pasur cilësinë e anëtares së trupës gjyqësore.

37.2 Nga analizimi i fakteve të përgjithshme të themelit të çështjes evidentohet se Këshilli i Ministrave, si palë me interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje, duke pretenduar se ka pasur falsitet të dokumentacionit të regjistrimit të disa pasurive tokë kullota në B, Sarandë, ka paditur trashëgimtarët e të ndjerit I.D, të cilët i kanë përfituar këto pasuri me vendim të Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë (KVKKP). Në padinë drejtuar gjykatës vërehet se kanë kërkuar pavlefshmërinë e vendimit nr. ***, datë 14.6.2006, të KVKKP-së, si dhe çdo veprimi juridik të mëvonshëm që mund të jetë kryer mbi pronën, me qëllim njohjen pronar të shtetit shqiptar të pronës me sipërfaqe rreth 60 ha tokë kullotë, duke goditur për falsitet vërtetimet e pronësisë, të lëshuara në favor të z. I. D dhe zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë së vendimit të KVKKP-së Vlorë, nëpërmjet fshirjes në regjistrin hipotekor të pronësisë së regjistruar në emër të palëve të paditura, si dhe regjistrimin e pronave në emër të shtetit shqiptar. Në lidhje me këtë çështje, si fillim është proceduar me marrjen e masës së sigurimit të padisë³³, duke bllokuar çdo veprim disponimi në lidhje me pasurinë objekt gjykimi.

37.3 Komisioni, pasi analizoi rrethanat e faktet në raport me legjislacionin material e procedural, konstatoi disa gjetje të kriterit profesional në vendimmarrjen e kësaj çështjeje, të lidhura me respektimin e parimeve procedurale të disponibilitetit të padisë dhe kontradiktoritetit, për të cilat i kërkoi subjektit të rivlerësimit, si anëtare e trupës gjyqësore, të provonte të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa vijon:

37.4 Nga leximi i pretendimeve të paditësit (KM), kumulativisht në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, duket se gjykata nuk e ka përcaktuar në mënyrë të saktë objektin e mosmarrëveshjes në gjykim, si dhe shkakun e padisë, duke e zgjidhur mosmarrëveshjen në kundërshtim me shkakun e përcaktuar nga paditësi, pasi referuar pretendimeve të paditësit duket se kërkimi parësor në padi, prej të cilit varen edhe kërkimet e tjera, është kërkimi për falsitetin e

²⁹ Shihni nenin 9 të ligjit.

³⁰ Protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 30.5.2022.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2023.

³² Vendim nr. ***, datë 3.5.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe vendim nr. ***, datë 21.2.2022, i Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë.

³³ Vendosur me vendimin nr. ***, datë 14.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

dokumenteve të pronësisë, ku është bazuar dhënia e vendimit të KVKKP-së Vlorë për njohjen e të drejtës së pronësisë, e cila e bën veprimin absolutisht të pavlefshëm, ndërkohë që gjykata është bazuar në analizimin e disponimit të së drejtës së pronësisë të pronarit (duke arsyetuar se nuk provohet vijimësia e të drejtës së pronësisë apo marrjes pa të drejtë të pronës nga shteti të familjes D), në kuptim të ligjit nr. 9235/2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, duke synuar ta lidhë këtë arsyetim me pavlefshmërinë e vendimit të KVKKP-së Vlorë.

37.5 Për rrjedhojë, për shkak të zgjidhjes së dhënë konfliktit, duket se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtares së trupës gjyquese, ka shkelur parimet themelore në lidhje me disponibilitetin e padisë përcaktuar në nenet 5³⁴, 6³⁵ dhe 28³⁶ të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në vendimin unifikues nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit është unifikuar praktika në lidhje me kuptimin e elementeve të kërkesëpadisë, objektit, shkakut, si dhe më së shumti rolit të gjykatës në identifikimin e këtyre elementeve. Referuar këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara kanë arsyetuar se: “*Shkaku i padisë nuk duhet ngatërruar me të ashtuquajturën ‘bazë ligjore’ apo referenca ligjore që ndeshet në kërkesëpadi. Shkaku i padisë përbëhet nga dy elemente: (1) e drejta subjektive, e cila gjen burimin e saj tek e drejta objektive; dhe (2) gjendja e faktit kundër kësaj të drejte (causa petendi)*”.

37.6 Nga shkelja e parimit të disponibilitetit të padisë nëpërmjet shqyrtimit kryesisht nga gjykata të një shkakut të ri të padisë, i ndryshëm nga shkakut i pasqyruar në pretendimet e paditësit, kjo gjykatë duket se ka shkelur edhe parimin e kontradiktoritetit, parashikuar në nenin 20³⁷ të Kodit të Procedurës Civile. Pra, gjykata, duke ndryshuar kryesisht shkakun e padisë, jo vetëm që ka lejuar shqyrtimin e fakteve që nuk janë pretenduar nga asnjë prej palëve, por *de facto* ka vepruar në kundërshtim me nenet 18³⁸ dhe 19³⁹ të Kodit të Procedurës Civile, duke mos i dhënë mundësinë palëve ndërgjyqëse dhe, veçanërisht palës së paditur për t’u dëgjuar, për të debatuar apo për të paraqitur prova në lidhje me këto fakte apo pretendime të reja.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

38. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë të detajuar në lidhje me themelin e kësaj çështjeje vendimmarrjen e saj, duke sqaruar se ka zbatuar plotësisht jo vetëm dispozitat e ligjit procedural e material, por edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Subjekti ka sqaruar se në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes ka mbajtur në konsideratë natyrën juridike të padisë, objektin kryesor të kërimit dhe shkakun e padisë, i cili në thelb konsiston në njohjen pronar të shtetit shqiptar mbi sipërfaqet e kërkuara.

38.1 Subjekti i rivlerësimit është ndalur në jurisprudencën e konsoliduar në lidhje me çështjet e kthimit dhe kompensimit të pronave, duke theksuar se bazuar në vendimin nr. 27/2010 të Gjykatës Kushtetuese, vendimin unifikues nr. 4/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. 611, datë 7.2.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në zgjidhjen e çështjeve të tilla, gjykatat orientohen të ushtrojnë kontroll incidental mbi ligjshmërinë e

³⁴ Objekti i mosmarrëveshjes: “*Objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve. Pretendimet parashtrihen në aktin për fillimin e procesit gjyqësor, si dhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga ky proces. Objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshojë sipas kërkesave që lindin gjatë procesit, kur këto të fundit kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit*”.

³⁵ Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

³⁶ Gjykata në procesin gjyqësor civil: “*Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm*”.

³⁷ Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit.

³⁸ Kontradiktoriteti: “*Asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim*”.

³⁹ *Palët duhet t’i bëjnë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t’u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim.*

vendimit të ish-KKKP-së dhe mbi këtë bazë ka sqaruar se ka arsyetuar dhe vendosur për çështjen objekt konflikti gjyqësor.

38.2 Për sa i përket shkakut të padisë, subjekti ka shpjeguar se nuk ka krijuar shkak të ri në zgjidhjen e çështjes dhe as ka cenuar për rrjedhojë parimet e disponibilitetit dhe kontradiktoritetit, por ka pasur parasysh natyrën specifike të çështjes, për të cilën ekziston një praktikë e konsoliduar gjyqësore që ka orientuar për zgjidhjen e rasteve të njëjta. Ajo ka theksuar se nuk e ka injoruar vendimin unifikues nr. 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me identifikimin e shkakut në zgjidhjen e drejtë të një çështjeje, por në këndvështrim të kësaj jurisprudence ka vlerësuar se shkak i padisë ka qenë e drejta e ligjshme e pronësisë së shtetit, ndërsa objekti i padisë ka qenë njohja pronar e shtetit shqiptar.

38.3 Në konkluzion, subjekti ka theksuar se vendimmarrja ka qenë e kushtëzuar nga zbatimi i ligjit dhe interpretimi i tij, referuar jurisprudence në gjykime të kësaj natyre, udhëhequr nga parimi për të bërë drejtësi dhe për të vënë në vend të drejtën e cenuar dhe gjithnjë duke respektuar parimet e procesit të rregullt gjyqësor civil.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

39. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe u konsultua me legjislacionin në fuqi dhe praktikën gjyqësore të konsoliduar në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të kthimit dhe kompensimit të pronave, çmon se në lidhje me këtë çështje, për shkak të natyrës specifike të saj, subjekti i rivlerësimit e ka zgjidhur çështjen duke u bazuar ngushtësisht në praktikën gjyqësore të orientuar për rastet e njëjta.

39.1 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve të plota dhe të bazuara, arriti të bindë trupin gjykues se në shqyrtimin e kësaj çështjeje, ku ajo ka pasur cilësinë e anëtares së trupës, nuk janë shpërfillur kërkimet e palëve të formalizuara në objektin e padisë dhe as shkak i ligjshëm ku është bazuar kërkesëpadija, porse ajo në cilësinë e gjyqtarës bashkë me anëtarët e tjerë të trupës kanë vlerësuar në mënyrë autonome faktet e çështjes, duke mbajtur në konsideratë sa është parashtruar në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, bazuar në vendimin unifikues nr. 3/2012⁴⁰ të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili i jep gjykatës rol të pavarur lidhur me interpretimin e fakteve.

39.2 Në përfundim, trupi gjykues, duke u bazuar në: (i) shpjegimet e subjektit; (ii) praktikën e konsoliduar⁴¹ në zgjidhjen e çështjeve të kthimit dhe kompensimit të pronave të natyrës *sui generis*; (iii) faktin se subjekti në këtë çështje ka pasur cilësinë e anëtarit të trupës gjykuese, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit – çmon se subjekti në këtë çështje ka provuar mjaftueshëm se ka zbatuar dispozitat ligjore që garantojnë një proces të rregullt gjyqësor.

40. Denoncim i shtetasit G.L., i depozituar pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit⁴² dhe protokolluar në Komision⁴³. Ky shtetas ka denoncuar disa subjekte, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, ku ankohet, ndër të tjera, për vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në lidhje me caktimin e masës “arrest në shtëpi” ndaj të dyshuarit G.Gj për shkak të kushteve shëndetësore, në rrethanat kur gjyqtarja kishte informacion se ky shtetas ishte proceduar edhe për 3 vepra penale.

⁴⁰ “Në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykata paraqitet në rolin e një arbitri asnjansës, i cili vlerëson në mënyrë të paanshme pretendimet e palëve dhe në fund i shpall ato të bazuara apo jo”.

⁴¹ Vendimi unifikues nr. 4/2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 611, datë 7.2.2011, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës Kushtetuese.

⁴² Nr. ***, datë 6.1.2020.

⁴³ Nr. *** prot., datë 7.3.2023.

40.1 Nga vlerësimi i fakteve dhe dokumentacionit të administruar⁴⁴ vërehen këto fakte: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2019 për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi G.L, i cili ka kallëzuar se është mashtuar nga shtetasi G.Gj në blerjen e dy apartamenteve në Dhërmi. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka kryer veprimet hetimore, ka proceduar me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit G.Gj.

40.2 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka vlerësuar rrethanat dhe faktet mbi të cilat është paraqitur dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nga shtetasi G.Gj, kushtet për caktimin e masës së sigurimit personal, si dhe kriteret e veçanta për caktimin e masës “arrest në burg”, me vendimin nr. ***, datë 12.12.2019, ka vendosur si masë sigurimi personal “arrest në burg” ndaj shtetasit G.Gj.

40.3 Nga analizimi i vendimit nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë proceduar me vendimin “arrest shtëpie”, sikurse pretendohet nga faktet në denoncim. Gjithashtu, Komisioni në këtë çështje nuk evidentoi *indicie* të kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

41. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi në gjykimin e çështjeve, në analizimin dhe interpretimin e ligjit. Gjithashtu, nga analizimi i burimeve që kanë shërbyer për vlerësimin profesional vërehet se subjekti i rivlerësimit ka qenë eficiente në zgjidhjen e çështjeve brenda afatit të caktuar, si dhe ka respektuar të drejtat e palëve në proces.

41.1 Trupi gjykues vlerëson se, bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Esmerilda Habili ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të gërmës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁴⁴ Me kërkesën nr. *** prot., datë 24.2.2023, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.2.2023.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Esmerilda Habili, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 11.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

	31.10.2014 - 31.12.2014	2015	2016
A) PASURI	15,635	-17,887	96
Ndryshim likuiditeti	15,635	-17,887	96
B) DETYRIME	0	0	0
C) PASURI NETO (A-B)	15,635	-17,887	96
D) TË ARDHURA	139,885	998,006	1,093,964
Të ardhura nga paga e subjektit	139,885	998,006	1,093,964
E) SHPENZIME	76,666	464,276	734,329
Shpenzime minimale jetike	36,666	224,276	235,092
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit			319,237
Shpenzime qiraje	40,000	240,000	180,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	47,584	551,617	359,539